

Shënime për plotësimin e Formularit E-SIG 025/a.2

”Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi” (Biznesi i Vogël)

- 1) Për ato raste kur tatimpaguesit i duhet të plotësojnë më shumë se një faqe listëpagese atëherë për çdo muaj të tremujorit plotëson listëpagesë sipas formatit E-SIG 025/a.1 dhe brenda afatit i dorëzon direkt në organin tatimor.
 - 2) Shenoni numrin tuaj të NIPT-it; emrin e regjistruar në organin tatimor; statusin e subjektit shënoni person Juridik apo person Fizik (I vetepunesuar) dhe si i vetepunesuar je: i vetem, me punemarres, me punonjes te papaguar te familjes, me punemarres dhe me punonjes te papaguar te familjes; apo i regjistruar si i vetepunesuar ambulant, apo kryefamiljar që punëson puntorë shtëpie. Shenoni veprimtarine kryesore ekonomike.
 - 3) Shenoni periudhen tatimore ne formatin VVVV/MM p.sh. 2009/05 ku shifra MM eshte tremujori i listepageses. Per cdo tremujor kalendarik duhet te dorezohet nje listepagese me ndarje sipas muajve.
 - 4) Shenoni emrin e rrethit ku subjekti ushtron veprimtarine ekonomike.
 - 5) Shenoni ne kete kolone numrin e sigurimeve shoqerore (NSSH) te cdo të punësuarit, si dhe i vetepunesuarit per vete dhe per punonjesit e papaguar te familjes, gjithashtu dhe i vetepunesuarit ambulant, apo dhe për puntorin e shtëpisë.
 - Shenim 1: Personi Fizik:** I vetepunesuar i vetem dhe me punonjes te papaguar te familjes (me ose pa punemarres), per veten e vet dhe per punonjesit e papaguar te familjes, si dhe i vetepunesuarit ambulant, apo dhe për puntorin e shtëpisë, do te lere bosh kollonat 10, 14 dhe 15, dhe gjithe shumen e kontributeve te sigurimeve shoqerore do ta regjistroje ne kolonat 12 dhe 13. Per punonjesit e papaguar te familjes ne reshtin e kolonave 13, 14 dhe 15 do te shenoje lidhjen e te vetepunesuarit me punonjesit te papaguar te familjes me te cilet personi fizik punon e bashkejeton, p.sh. grua, i biri, e bija, etj. Formularin do ta dorezoni edhe kur punoni si i vetepunesuar i vetem.
 - 6) Shenoni emrin e mbiemrin e cdo punonjësi kundrejt Numrit të Sigurimit Shoqëror të cdo personi, të cilin subjekti e merr në organet e sigurimeve shoqërore. Pas emrit shenoni detyrën, profesionin apo punën ku ai ka punuar.
 - 7) Shenoni numrin e kategorise se punonjësve si vijon: 1 -Numer i paracaktuar per punemarresit me kohe te plote. Per keta punemarres ne listepagese nuk shënohet asnjë numër; 2 -punuar me kohe te pjeseshme me pak se 87 orë në muaj; 3 -punuar si i perkohshem me pak se një javë gjate vitit; 4 -persona ne kurse, si dhe studente ne praktika mesimore të miratuara dhe me kontratë me institucionet përkatëse; 5 -punemarresit e tjere; 6 -personi fizik; 7 -punonjes i papaguar i familjes të personit fizik; 8 - i vetëpunësuar ambulant; 9 - Punëtor shtëpie;
 - 8) Shenoni ditet kalendarike te pa punuara gjate muajit nga punemarresit, per ato raste qe ai duhet te marre perfitime afatshkurta nga skema e sigurimeve shoqerore, p.sh. dite raport paaftesie te perkoheshme (duke filluar nga dita e 15 e raportit), dite me leje barre lindje; etj. perfitime sipas ligjit. Neqofese nje punemarres per te gjithë muajin ka qene me raport, apo leje barre lindje etj. perfitime nga skema e sigurimeve shoqerore, emri i tij do te pasqyrohet ne listepagese, do te shenohet numeri i te gjitha diteve te muajit, ndersa kolonat e tjera nuk plotesohen.
 - 9) Shenoni ditet kalendarike te muajit ne te cilat punemarresi ka punuar tek subjekti juaj. Keto dite te punuara duhet te jene te rakorduara me deklarimet e dorezuara gjate muajit ne degen e tatimeve me formularet “Pasqyra e te punesuarve për here të pare, atyre rishtazi, si dhe e te larguarve nga puna”. Ketu do te shenoni dhe ditet me raport deri ne ditën e 14 me raport per te cilat punëmaresi paguhet sipas Kodit te Punes dhe i llogariten kontribute.
 - 10) Shenoni pagën bruto gjithsej qe i keni dhene punemarresit gjate muajit. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose cdo funksion tjetër, per efekt te pageses se kontributeve dhe tatimit mbi te ardhurat nga punesimi trajtohen njelloj si gjithe punëmaresit e tjere te subjektit. Personi fizik per vete dhe punonjesit e papaguar te familjes këtë kolonë e le bosh.
 - 11) Shenoni pagën gjithsej mbi te cilen llogariten kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shendetesore ne perputhje me kerkesat e VKM. përkatës. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë ose cdo funksion tjetër trajtohen njelloj si cdo punëmarrës tjetër i subjektit. Personi fizik per vete dhe punonjesit e papaguar te familjes shenon pagen minimale sipas VKM. përkatës.
 - 12) Shenoni kontributin gjithsej te sigurimeve shoqerore per tu paguar nga punedhenesi dhe punemarresi. Sipas muajve mblidhni shumen e kolones 12 dhe në fund të kolonës mblidhni totalin për të tre muajt. Totali për tremujorin e shenuar ne pasqyre duhet te jete i barabarte me shumen e kontributeve te pasqyruara ne deklaraten e kontributeve të periudhes korensponduese.
 - 13) Shenoni kontributin e sigurimeve shoqerore per tu paguar nga punedhenesi gjate muajit sipas pages mbi te cilen llogariten kontributet [shih kollonen 11] shumzuar me perqindjen perkatese sipas VKM. përkatës. Personi fizik per vete dhe punonjesit e papaguar te familjes, i vetëpunësuarit ambulant, dhe kryefamiljari për puntorin e shtëpisë, në këtë kolonë regjistron të gjithë shumen e kontributit. Sipas muajve mblidhni shumen e kolones 13 dhe në fund të kolonës mblidhni totalin për të tre muajt. Totali për tremujorin e shenuar ne pasqyre duhet te jete i barabarte me shumen e kontributeve te pasqyruara ne deklaraten e kontributeve të periudhes korensponduese.
 - 14) Shenoni kontributin gjithsej te sigurimeve shoqerore te mbajtur ne burim nga punedhenesi per punemarresin sipas pages mbi te cilen llogariten kontributet [shih kollonen 11] shumzuar me perqindjen perkatese sipas VKM. Personi fizik per vete dhe punonjesit e papaguar te familjes, i vetëpunësuarit ambulant, dhe kryefamiljari për puntorin e shtëpisë, këtë kolonë e le bosh. Sipas muajve mblidhni shumen e kolones 14 dhe në fund të kolonës mblidhni totalin për të tre muajt. Totali për tremujorin e shenuar ne pasqyre duhet te jete i barabarte me shumen e kontributeve te pasqyruara ne deklaraten e kontributeve të periudhes korensponduese.
 - 15) Nuk plotësohet nga subjektet e regjistruara në biznesin e vogël.
 - 16) Shenoni shumen gjithsej te kontributeve per sigurimet shendetesore per cdo punemarres gjate muajit, duke u bazuar ne pagen mbi te cilen llogariten kontributet [shih kollonen 11] shumzuar me perqindjen perkatese sipas VKM. Mblidhni Sipas muajve mblidhni shumen e kolones 16 dhe në fund të kolonës mblidhni totalin për të tre muajt. Totali për tremujorin e shenuar ne pasqyre duhet te jete i barabarte me shumen e kontributeve te pasqyruara ne deklaraten e kontributeve të periudhes korensponduese.
 - 17) Shenoni pagën bruto qe i keni paguar punemarresit gjate muajit dhe qe eshte baza per llogaritjen e tatimit mbi te ardhurat nga punesimi sipas kerkesave te Ligjit per Tatimin mbi te Ardhurat. Sipas muajve mblidhni shumen e kolones 17 dhe në fund të kolonës mblidhni totalin për të tre muajt. Totali për tremujorin e shenuar ne pasqyre duhet te jete i barabarte me shumen perkatese te pasyruar ne deklaraten e Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi të periudhes korensponduese.
 - 18) Shenoni tatimin mbi te ardhurat nga punesimi te mbajtur ne burim nga paga e cdo punemarresit gjate muajit. Sipas muajve mblidhni shumen e kolones 18 dhe në fund të kolonës mblidhni totalin për të tre muajt. Totali për tremujorin e shenuar ne pasqyre duhet te jete i barabarte me shumen perkatese te pasyruar ne deklaraten e Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi të periudhes korensponduese.
 - 19) Shenoni numrin e personave, për të cilët, sipas kësaj listëpagese, janë llogaritur kontribute për periudhën TREMUJORE, pavarësisht nga numri i ditëve të punuara, e cila është e barabartë me shumën e numrit të kontributpaguesve të të tre muajve të tremujorit përkatës (I+II+III), e shprehur ndryshe në muaj nerëz kontribute. Kjo shumë mund të mos jetë e barabarte me numrin gjithsej te punonjesve qe permban listepagesa për të tre muajt, sepse ne listepagese jane te regjistruar edhe punonjesit të cilet per një muaj të plotë kane qene me raport paaftesie te perkoheshme, leje barre lindje etj. perfitime nga skema e sigurimeve shoqerore; etj. raste, të cilat pasqyrohen në listëpagesë vetëm për efekt të verifikimeve që bëjnë organet e sigurimeve shoqërore për këta përfitues nga skema e sigurimeve. Në plotësimin e listëpagesës të tregohet kujdes për të përfshirë, sipas muajve përkatës, të dhënat e deklaruara në organin tatimor me firmuarët “Pasqyra e te punesuarve për here të parë, atyre rishtazi dhe te larguarve” E-SIG027/a te dorezuara në këto organe gjate muajve të periudhës tremujore, ne kohen kur kane ndodhur ndryshimet e numrit punonjese.
- Numri i punonjesve ne kete rubrike, i shprehur në muaj njerëz kontribute, duhet te jete i barabartë me numrin qe permban formulari i deklarimit të kontributeve E-SIG011-012/a. në rubrikën 16 të tij.*
- Shenimi 1:** Vleresimet e organit tatimor, për kontribute shtese, jane rjedhoje e diferencave nga deklarimet: a) per numerin e punonjesve b) per pagat e tyre. Ne keto raste cdo Person Juridik e Fizik, duhet te dorezoje ne organin tatimor nje listepagese shtese model E-SIG 025/a.1, me shumen e kontributeve te shtuara, per ate periudhe tatimore qe eshte kryer vleresimi. Keto listepagesa administrohen njelloj si gjithe listepagesat
- Shenim 2:** Me këtë listepagese, deklarohen pagat dhe kontributet përkatëse për sigurimet shoqërore e shëndetësore të llogaritura sipas rregullave të përcaktuara me Ligj dhe Vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për: të vetëpunësuarit për vete, të punësuarit, punonjësit e papaguar të familjes së të vetëpunësuarit, mbi 16 vjeç, me të cilët ai punon e bashkejeton ligjërisht, të vetëpunësuarit ambulantë, si dhe puntorët e shtëpisë, sipas rasteve. Gjithashtu listëpagesa perdoret edhe per te pasqyruar leket qe ju duhet t’u mban ne burim punemarresve tuaj per tatimin mbi te ardhurat nga punesimi (TAP) në shumat sipas Ligjit përkatës.
- Shenim 3:** Totala e tremujorit te kolonave të listëpagesës duhet te jenë të barabarta me të dhënat përkatëse të formularit te deklarimit te kontributeve E-SIG011-012/a, si dhe të formularit te deklarimit per TAP-in.
- Shenim 4:** *Persona Juridike dhe fizike te regjistruar në biznesin e vogel:* Per cdo tremujor, brenda datës 20 te muajit të parë pas perfundimit të cdo tremujori te vitit kalendarik (pra brenda datave: 20 prill, 20 korrik, 20 tetor, 20 janar) ju duhet te dorezoni kete listepagese, e cila eshte e vendosur prapa faqes se kopjes se trete te formularit te deklarimit E-SIG011-012/a, se bashku me dy kopjet e tjera qe permbajne vetem formularin e deklarimit. Pra listëpagesa e plotësuar qartë dhe e firmosur dorëzohet në bankat e nivelit të dytë ose në postën shqiptare bashkelidhur me tre kopjet e formularit të deklarimit të kontributeve, e vendosur në faqen e prapme të kopjes së tretë të këtij formulari.
- Shenim 5:** Listëpagesa, mbasi perpunohet nga organet tatimore dergohet zyrtarisht ne organet e sigurimeve shoqerore ku arkivohet dhe perdoret per te vertetuar perfitimet qe i takojne te mare nga skema e sigurimeve shoqerore cdo punonjese qe ka paguar kontribute. Neqofese nuk dorezohet listepagesa nuk mund te evidentohen kontributet e paguara për cdo person.
- Shenim 6:** *Per dorezimin e Listepageses jashtë afateve, si me sipër, vendosen Gjoha sipas ligjit.*

